

KONTRATE SHITBLERJE PASURISË E LUAJTSHME (SHITJE KUOTASH)

Sot më datë 23/10/2020 (dymijë e njetete) palet e meposhtme redaktuan kete kontrate shitje:

PALA SHITËSE:

Z. RENATO QARRI atesia SABAUDIN lindur me 06.10.1991 ne Vlore dhe banues në Tirane, madhor me zotësi të plotë juridike e për të vepruar mbajtes i leternjoftimit me nr personal J11006055C

në vijim e për efekt të kësaj Kontrate referuar si "Shitësi");

BLERESI: ORGEST XHELAJ atesia SABAUDIN i lindur ne Vlore me date 23.06.1987 dhe banues ne Tirane, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar i identifikuar me pasaporten me nr personal I70623056B(në vijim e per efekt të kësaj Kontrate referuar si "Blerësi");

Në vijim e per efekt të kësaj Kontrate, Shitësi dhe Blerësi do të referohen veçmas si Palë dhe së bashku si Palë.
MEQENËSE:

Shoqëria "MHE Albania" Sh.p.k (ne vijim "Shoqëria") është një shoqëri tregtare me përgjegjësi te kufizuar, e krijuar e qe funksionon ne përputhje me legjislacionin shqiptar, e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare te Regjistrimit me Numër Unik Identifikimi NUIS **L71402055C**, të ndarë në 2 kuota dhe sikurse rezulton nga regjistrimet në Regjistrin Tregtar Shitësi zotëron.

RENATO QARRI zotërues i 1 kuote me 70 % te pjesemarrjes ne Kapital me vlere prej 70 000 leke

ORGEST XHELAJ

zotërues i 1 kuote me 30 % te pjesemarrjes ne Kapital me vlere prej 30 000 leke

Shitësi i ka njoftuar Blerësit ofertën e tij për shitjen e 70 % (shtatedhjete perqind) te kapitalit te Shoqërisë dhe Blerësi ka pranuar të blejë pjesëmarrjen e ofruar nga Shitësi në Shoqëri;

a.Në zbatim të të kërkesave të Statutit Shoqërisë dhe pas miratimit përkatës sipas Vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, bashkëlidhur, Palët kanë vendosur të lidhin këtë Kontratë;**ATËHERË,** duke qenë se ekzistojnë këto kushte paraprake, për të cilat Palët nuk kanë pretendime apo kundërshtime, Palët bien dakord për sa më poshtë vijon:

Neni 1 Objekti

1.1. Nëpërmjet kësaj Kontrate Shitësi i shet Blerësit 70 % (shtatedhjete perqind) te kapitalit te Shoqërisë dhe konkretisht: 70 % (shtatedhjete perqind) e barazvlefshme me nje kuote nga ortaku **RENATO QARRI me vlere 70 000 leke dhe** Blerësi blen pjesëmarrjen e mësipërme nga Shitësi

Neni 2 Cmimi

Çmimi i shitjes se kuotave te 70 % te kapitalit eshte 70 000(shtatedhjete mije) leke te reja shume e cila eshte paguar nga bleresi ne favor te shitesit . jashte kesaj kontrate shitjeje.

Neni 3 Deklarimet dhe garancite

3.1 Shitësi deklaron dhe vërteton se në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate ai zotëron pjesëmarrjen e transferuar sipas kësaj Kontrate, dhe se nënshkrimi apo zbatimi i kësaj Kontrate nga Shitësi nuk vjen në kundërshtim me ligjet, Statutin, apo dokumente të tjera ligjore, subjekt i të cilave është Shitësi. **Shitesi deklaron se ja shet bleresit kuotat e zoteruara prej tij ne vleren prej 70 000 (shtatedhjete mije) leke te reja, bashke me te gjitha te drejtat e detyrimet qe**

shoqeria ka ndaj organeve tatimore, shoqerive te tjera apo paleve te trete.

- 3.2. Blerësi deklaron dhe vërteton se nënshkrimi apo zbatimi i kësaj Kontrate nga Blerësi nuk vjen në kundërshtim me ligjet, subjekt i të cilave është Blerësi.

Bleresi deklaron se është njohur me dokumentacionin dhe me gjendjen e korrtabilitetit të Shoqërisë dhe deklaron se është dakord të blejë kuotat në vlerën prej 70 000 (shtatëdhjetë mijë) leke të reja, bashkë me të gjitha detyrimet që shoqeria ka ndaj shtetit apo shoqerive të tjera apo paleve të trete.

Bleresi deklaron se është dakord të likujdojë të gjitha detyrimet ndaj ndaj shtetit apo shoqerive të tjera apo paleve të trete.

Neni 4 Transferimi i të drejtave

- 4.1. Pronësia mbi kuotat e Shoqërisë, objekt i kësaj Kontrate, kalon nga Shitësi të Blerësi menjëherë me nënshkrimin e kësaj Kontrate
- 4.2. . Kjo Kontrate nuk është dhe në asnjë rast nuk do të interpretohet si një kontratë shitje me rezerve pronësie. Kalimi i pronësisë së kuotave të Shoqërisë në favor të Blerësit do të regjistrohet menjëherë në Qendrën Kombëtare të Biznesit në përputhje me Ligjin 9901/2008, të ndryshuar dhe Ligjin 9723/2007, të ndryshuar.
- 4.3. Pas nënshkrimit të kësaj Kontrate, struktura e zotërimit të kapitalit të Shoqërisë do të jetë:
- 4.4.

1-ORGEST XHELAI zoteron 1 kuotë që perben 100%(njqind perqind)te kapitalit themeltar te shoqerise "MHE Albania"sh.p.k me vlere 100 000 (njeqind mije)leke.

4.4Me nenshkrimin e kesaj Kontrate ,Bleresi gezon te gjitha te drejtat per te rregjistruar pronesine mbi kuotat ne Regjistrin Tregtar si dhe prane cdo institucioni tjeter sipas legjislacionit ne fuqi.

Neni 5 Të ndryshme

- 5.1. Çdo kusht, klauzolë apo parashikim i kësaj Kontrate do të jetë i vlefshëm pavarësisht kushteve, klauzolave apo parashikimeve të tjera dhe vlefshmëria e një kushti, klauzole apo parashikimi nuk do të çenohet nga pavlefshmëria e një kushti, klauzole apo parashikimi tjetër.
- 5.2. Kjo Kontratë do të interpretohet dhe zbatohet në përputhje me dispozitat e Ligjit 9901/2008, të ndryshuar dhe Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.
- 5.3. Çdo konflikt që ka lindur si pasojë apo lidhet me këtë Kontratë do të zgjidhet në marrëveshje ndërmjet Palëve, në rast të kundërt kompetente për zgjidhjen e konflikteve është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane.
- 5.4. Kjo Kontratë hartohet në gjuhën shqipe në 3 (tre) kopje origjinale.

PALET KONTRAKTUESE

Lexuar, aprovuar dhe nënshkruar nga:

**PALA SHITËSE
RENATO QARRI**

**PALA BLERËSE
ORGEST XHELAI**